



# “Raporti monitorues i zbatimit të Planit Buxhetor për Rininë në Bashkinë Përmet”

Qershor 2020





**Autor:**

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve



© Aplikimet për leje për të shumëfishuar ose përkthyer pjesë nga ky publikim duhet të dërgohen në:

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve  
Rruga "Brigada e VIII", Pall. LID, K.1, Z.1, Tiranë, Shqipëri  
Email: [info@observator.org.al](mailto:info@observator.org.al)  
Webmail: [www.observator.org.al](http://www.observator.org.al)

Ky publikim është realizuar nga UNFPA me ekspertizën e Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve (Observatori), në kuadër të projektit "Leave No One Behind" ("Askush të mos Mbetet Pas"), një Program i përbashkët i OKB-së i financuar nga Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC) dhe zbatuar nga katër agjensi të OKB: UNDP, UNFPA, UNICEF, dhe UN WOMEN në partneritet me Qeverinë Shqiptare. Ky projekt synon fuqizimin e personave vulnerabël në Shqipëri që të kenë akses të barabartë në shërbimet dhe mundësitë publike, të kenë një zë në vendimmarrjen publike, që ndikon në jetën e tyre dhe t'i kërkojnë llogari zyrtarëve publikë, duke i mbajtur përgjegjës për dështimet apo arritjet.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e Observatorit, në emër të Rrjetit të Organizatave "Zëri i të Rinjve". Opinionet e shprehura këtu janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionet e UNFPA-së, UN Albania apo SDC.

*“Mos investimi tek Rinia pasqyron në shoqëri mungesë dhembshurie dhe dështim të ndjenjës së solidaritetit” - Coretta Scott King*

Vendimmarrësit duhet të njohin dhe vlerësojnë që angazhimi i të rinjve në shoqëri shërben si një mjet i rëndësishëm për zhvillimet demokratike. Ndarjet social-ekonomike të shoqërisë sonë, përjashtimi social, papunësia, pamundësia për edukim profesional dhe varfëria, po prekin gjithnjë e më shumë njerëz, dhe veçanërisht të rinjtë. Ndaj është shumë e rëndësishme të nxisim dhe zhvillojmë angazhimin qytetar dhe shoqëror të të rinjve që nga niveli vendor (lokal) deri në atë kombëtar e më gjerë.

Tashmë Shqipëria ofron një panoramë optimiste ligjore në lidhje me kornizimin për garantimin dhe zbatimin e të drejtave të të rinjve në vend. Ligji nr. 75/ 2019 “Për Rininë” u miratua në Nëntor të 2019, duke bërë të mundur integrimin dhe bashkëndimin e shumë dokumenteve ligjore dhe politik të hartuar më parë, siç janë: Ligji për Vetëqeverisjen vendore, Ligji për Financat e Vetëqeverisjes Vendore, Plani Kombëtar I Veprimit për Rininë 2015-2020.

Të dhënat demografike tregojnë se të rinjtë (grupmosha 15-29 vjeç) përbën rreth 25% të popullsisë në vend. Ndërkohë, përsa i përket të dhënave në nivel lokal në Bashkinë Përmet për rininë, siç janë: demografia, buxhete të realizuara, aktivitetet dhe bashkëpunimet, planet vendore dhe planet buxhetore, është realizuar dhe publikuar në vitin 2018 një analizë e situatës nga UNFPA me ekspertizën e Observatorit, në kuadër të projektit “Leave No One Behind” (“Askush të mos Mbetet Pas”).

Kjo analizë është konsideruar e vlefshme nga Bashkia Përmet si një dokument i rëndësishëm referimi për të identifikuar prioritetet për t’u adresuar nëpërmjet aktiviteteve si dhe për të aplikuar në projekte të ndryshme.

Ky raport monitorimi është realizuar për të vlerësuar ecurinë e zbatimit të këtij plani buxhetor për rininë në nivel lokal, si dhe për të matur dhe vlerësuar qasjen e ligjit të ri për rininë të zbatuar në politikatat vendore.

## METODOLOGJIA E MBLEDHJES SË INFORMACIONIT PËR RAPORTIN MONITORUES

*Ky raport monitorimi ka si qëllim monitorimin e ecurisë së zbatimit të planeve buxhetore për rininë në nivel vendor, duke vlerësuar zbatimin e Ligjit 75/2019 "Për Rininë" (miratuar në Nëntor 2019), si dhe shërbimet dhe programet për të rinjtë, konceptuar si funksion publik apo si shërbim i veçantë posaçërisht për të rinjtë ofruar nga qeverisja vendore.*

Mbledhja e të dhënave për këtë monitorim është bazuar në 3 burime informacioni:

- **1. Formulari për mbledhjen e të dhënave nga Bashkia** – i cili është bazuar në formularin e parë duke ruajtur disa pyetje bazë, siç janë: të dhënat mbi numrin e të rinjve, shkollat, qendrat sociale, buxheti. Duke i'u referuar këtyre pyetjeve nisur dhe nga vlerësimi i parë, është krijuar panorama krahasimore e ndryshimit në kohë. Formulari është pasuruar më tej me pyetje të cilat evidentojnë se (i) deri në ç'masë janë zbatuar planet e parashikuara në dokumentin e parë; (ii) krijimi dhe zhvillimi i infrastrukturës rinore dhe të hapësirave rinore të sigurta (qendra rinore, qendra shumë-funksionale, etj); (iii) ngritja dhe funksionimi i Këshillit Vendor Rinor (KVR) duke analizuar: pengesa, nevoja, vështirësi, histori suksesi, etj; (iv) (nëse janë hartuar) standarte për ofrimin e veprimtarive rinore dhe punësimin e të rinjve; (v) nxitja e vullnetarizmit të të rinjve dhe edukimi joformal i tyre; (vi) mbledhja e të dhënave dhe raportimi mbi situatën e të drejtave të të rinjve; (vii) aplikimet e realizuara dhe të fituara nga Njësitë e Qeverisjes Vendore (NJQV) me fokus ose përfshirë tematikën rinore; (viii) marrëveshjet e realizuara me fokus ose përfshirë tematikën rinore; (ix) bashkëpunimet apo aktivitetet rinore të realizuara në bashkëpunim me institucione të tjera lokale, qendrore apo ndërkombëtare; (x) aktivitete informuese mbi Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm/ Sustainable Development Goals (OZHQ/SDGs).
- **2. Pyetësor me të rinjtë** – Nisur dhe nga pyetësi i parë i përdorur për hartimin e Planit të Buxhetimit për Rininë, ky pyetësor është bazuar në: (i) programet që Bashkia ka për të rinjtë, (ii) marrjen e njoftimeve dhe informacioneve, (iii) vlefshmërinë dhe dobishmërinë e këtyre aktiviteteve dhe informacioneve nga ana e të rinjve, (iv) nevojat që të rinjtë kanë, si dhe marrëdhëniet që vetë të rinjtë kanë me njëri tjetrin; (v) nxitjen e vullnetarizmit të të rinjve dhe edukimin joformal të tyre; (vi) bashkëpunimet apo aktivitetet rinore të realizuara në bashkëpunim me institucione të tjera lokale, qendrore apo ndërkombëtare; (vii) Aktivitetet informuese mbi OZHQ.
- **3. Fokus grup me të rinjtë** që janë pjesë e KVR dhe/ ose të rinj që kanë përfutur nga veprimtaritë e Qendrave shumë-funksionale apo qendrave rinore, - kjo nisur nga fakti që mund të ketë Bashki që nuk i kanë krijuar ende KVR dhe/ ose mund të jenë të jenë ngritura së fundmi dhe nuk kanë shumë informacion për të ofruar. Në këto fokus grupe është vjelur informacion mbi: (i) rolin e tyre si ndërmjetës midis grupeve rinore të ndryshme (në bazë etnike, grupmoshe, arsimit, formimit, vendbanimi/ lagje, etj) dhe Bashkisë, (ii) evidentimi i pikave të forta dhe të dobëta të KVR, (iii) hapat e mundshme për përmirësimin e funksionimit të tyre.

### 1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM



Numri i të rinjve 15-29 vjeç<sup>1</sup>

Viti 2017- 5,325 të reja/rinj

Viti 2019- 5,349 të reja/rinj

***Numri i të reja/rejve është rritur me 0.5%***



Numri i institucioneve arsimore

Në Bashkinë Përmet ka 2 shkolla të mesme dhe nuk ka asnjë universitet.<sup>2</sup>



Numri i qendrave komunitare

Në Bashkinë Përmet ka 2 qendra shumë-funksionale (Qendra Kulturore Multifunksionale dhe Qendra Komunitare), ku njëra është ndërtuar gjatë periudhës 2018-2019, por nuk ka asnjë qendër rinore.<sup>3</sup>

- ***55% e të rinjve të anketuar pohojnë se janë në dijeni të ngritjes së Qendrës Rinore/ Shumë-funksionale.<sup>4</sup>***
- ***57% e të rinjve të anketuar mendojnë se ngritja/ funksionimi i tyre ka ndikuar në përmirësimin e jetës social-kulturore së të rinjve.<sup>5</sup>***



Numri i organizatave rinore/që kanë në fokus të rinjtë

Në territorin e Bashkisë Përmet vazhdon të mos ketë organizata lokale rinore ,por ***“shumë organizata kombëtare/ ndërkombëtare angazhojnë të rinjtë në implementimin e projekteve”.***

***57% e të rinjve të anketuar njohin organizata të ndryshme me fokus të rinjtë që operojnë në territorin e Bashkisë Përmet.***

***93% e tyre e konsiderojnë punën e tyre disi / shumë të vlefshme.<sup>7</sup>***

<sup>1</sup>Burimi: Bashkia Përmet, Maj - Qershor 2020

<sup>2</sup>Burimi: Bashkia Përmet, Maj - Qershor 2020

<sup>3</sup>Burimi: Bashkia Përmet, Maj - Qershor 2020

<sup>4</sup>Burimi: Pyetësor me të rinjtë, Maj - Qershor 2020

<sup>5</sup>Burimi: Pyetësor me të rinjtë, Maj - Qershor 2020

<sup>6</sup>Burimi: Bashkia Përmet, Maj - Qershor 2020

<sup>7</sup>Burimi: Pyetësor me të rinjtë, Maj - Qershor 2020

## 2. STRATEGJITË/POLITIKAT/AKTIVITETET E BASHKISË NË LIDHJE ME TË RINJTË

Në vitin 2020 është miratuar në Këshillin Bashkiak **Plani i Përgjithshëm Vendor**, i cili përfshin çështje që lidhen me rininë, siç janë: arsimimi, punësimi i tyre në sektorët prioritarë, etj.


Në bashkëpunim me Observatorin është hartuar në vitin 2018 Plan Buxhetimi me rininë dhe për rininë.<sup>8</sup>

**51% e të rinjve të anketuar janë në dijeni të programeve / prioriteteve të Bashkisë në lidhje me të rinjtë.**<sup>9</sup>

Të rinjtë gjithashtu njohin dhe ligjet/programet/prioritetet kombëtare apo ndërkombëtare që lidhen me rininë.

**"Jam në dijeni të Ligjit për Rininë, e kam dëgjuar në lëndën e Qytetarisë dhe kam mësuar për të më shumë në takimet lokale për të rinjtë në qytetin tim".**<sup>10</sup>

Grafiku 1: Përqindja e të rinjve që kanë informacion për:<sup>11</sup>



- Në Bashkinë Përmet nuk ka një manual me standardet për ofrimin e veprimtarive rinore dhe punësimin të të rinjve.<sup>12</sup>
- Gjatë vitit 2019 dhe 2020 Bashkia Përmet **po zbaton 8 projekte**, të cilat në mënyrë direkte ose indirekte përfshijnë rininë.<sup>13</sup> Nga këto, vetëm njëri ka filluar zbatimin në vitin 2019 dhe 7 projektet e tjera kanë filluar në vitin 2018. Këto projekte janë ngritur dhe zhvilluar nga vetë stafi i Bashkisë, pa ndonjë ndihmë apo ekspertizë ndërkombëtare apo lokale.<sup>14</sup>

Gjatë viteve 2018-2019 janë realizuar rreth 10 aktivitete në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetit Publik, Zyrën e Punës, Zyrën Vendore Arsimore, Ministrinë e Turizmit dhe Agjensinë Kombëtare për Zonat e Mbrojtura (AKZM).<sup>15</sup>

<sup>8</sup>Burimi:(<https://observator.org.al/wp-content/uploads/2018/12/Analiza-e-buxhetimit-per-rinine-ne-Bashkine-e-Permetit-Dhjetor-2018.pdf>),

Bashkia Përmet, Maj - Qershor 2020

<sup>9</sup>Burimi: Pyetësor me të rinjtë, Maj - Qershor 2020

<sup>10</sup>Burimi: Fokus grup me Këshillin Rinor, Maj - Qershor 2020

<sup>11</sup>Burimi: Pyetësor me të rinjtë, Maj - Qershor 2020

<sup>12</sup>Burimi: Bashkia Përmet, Maj - Qershor 2020

<sup>13</sup>Burimi:([http://www.bashkiapermet.gov.al/?page\\_id=1472](http://www.bashkiapermet.gov.al/?page_id=1472))

Programet për të rinjtë që Bashkia ka zbatuar gjatë periudhës 2019-2020 përfshijnë: Aktivitete kulturore, Trajtime në bashkëpunim me organizata të ndryshme, Programi i "Këndit të BE-së" si dhe konkurse.<sup>16</sup>

Pjesë e aktiviteteve ku është angazhuar Bashkia, kanë qenë dhe aktivitete për nxitje të vullnetarizmit të të rinjve dhe edukimit joformal. Këto aktivitete janë zhvilluar nga Këshilli Rinor dhe Këndi i BE-së.<sup>17</sup>

Bashkia gjithashtu është angazhuar në realizimin e aktiviteteve në lidhje me SDGs konkretisht që lidhen me SDG-të nr. 3, 6, 12, 13, 14, 15 dhe 16. Një ndër prioritetet e thirrjes RELOAD për vitin 2019 ishte "Përfshirje në aktivitete sociale-kulturore të lidhura me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm."<sup>18</sup>

Dhe vetë të rinjtë njohin dhe kanë ndjekur aktivitetet e organizuar si nga Bashkia direkt ashtu dhe në bashkëpunim me organizata të ndryshme.

*"EU corner, ose ndryshe Këndi i Bashkimit European ka organizuar herë pas here aktivitete me në qendër të rinjtë"*<sup>19</sup>

*"Organizata si CESVI<sup>20</sup> dhe International Council of Organizations of Folklore Festivals and Folk Art(CIOFF) na kanë përfshirë në projektet e tyre me fokus të rinjtë dhe turizmi, edukimi mjedisor dhe kulturor."*<sup>21</sup>

*57% e të rinjve kanë marrë pjesë në aktivitete të organizuara nga Bashkia për rininë gjatë vitit 2019 e në vazhdim.*<sup>22</sup>

---

<sup>14</sup>Burimi: Bashkia Përmet, Maj - Qershor 2020

<sup>15</sup>Burimi: Bashkia Përmet, Maj - Qershor 2020

<sup>16</sup>Burimi: Bashkia Përmet, Maj - Qershor 2020

<sup>17</sup>Burimi: ([http://www.bashkiapermet.gov.al/?page\\_id=2576;https://www.facebook.com/permyouthcouncil](http://www.bashkiapermet.gov.al/?page_id=2576;https://www.facebook.com/permyouthcouncil)), Bashkia Përmet, Maj - Qershor 2020

<sup>18</sup>Burimi: (<http://www.bashkiapermet.gov.al/?p=3318>), Bashkia Përmet, Maj - Qershor 2020

<sup>19</sup>Burimi: Fokus grup me Këshillin Rinor, Maj - Qershor 2020

<sup>20</sup>CESVI është një organizatë humanitare laike dhe e pavarur që vepron për solidaritetin botëror e themeluar në vitin 1985.

<sup>21</sup>Burimi: Fokus grup me Këshillin Rinor, Maj - Qershor 2020

<sup>22</sup>Burimi: Pyetësor me të rinjtë, Maj - Qershor 2020



### 3. ANGAZHIMI I TË RINJVE NË VENDIMMARRJE

- Në Bashkinë Përmet ka një **Këshill Rinor**, i cili është krijuar në vitin 2017. Këshilli Rinor është inicuar në bashkëpunim me Vullnetarët e Korpunit të Paqes dhe ka anëtarë 8 të reja/të rinj të regjistruar/a me dëshirën e tyre pas njoftimit të publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë. Aktualisht nuk ka një rregullore të funksionimit të Këshillit Rinor. Pengesa kryesore e hasur gjatë funksionimit të këtij Këshilli lidhet me faktin se përzgjedhja e anëtarëve është bërë në vitin 2017 dhe Anëtarët e Këshillit tashmë janë në Universitet duke mos mundur të angazhohen dhe të ndjekin funksionimin e tij. Këshilli Rinor ka si nevoja kryesore referimin e nevojave të të rinjve banorë në Bashkinë Përmet, si dhe rritjen e angazhimit në aktivitete dhe projekte të Bashkisë, Organizatave Jo-Fitimprurëse (OJF-ve) apo institucioneve të ndryshme.<sup>23</sup>

**68% e të rinjve të anketuar janë në dijeni të ekzistencës së Këshillit Rinor.**

**81% e tyre e konsiderojnë disi/shumë të vlefshëm rolin e tij në përcaktimin e prioriteteve të rinisë.<sup>24</sup>**

Mosfunksionimi i Këshillit Rinor këtë vit (2020) vihet në pah dhe nga vetë të rinjtë anëtarë të Këshillit:

*“Çdo vit ka pasur një Këshill Rinor në qytetin tonë, por këtë vit nuk u organizua dhe rinia ishte në pasivitet...”*

*“Që ky Këshill të funksionojë duhet më shumë organizim dhe kjo mund të bëhet e mundur duke patur një përfaqesues të Bashkisë si organizator.”<sup>25</sup>*

- Përsa i përket **pjesëmarrjes së të rejave/rinjve në proceset dhe vendimmarrjet demokratike**, angazhimi i tyre ka konsistuar në pjesëmarrjen e disa të rinjve në mbledhjet e Këshillit Bashkiak. Anëtarët e Këshillit Mjedisor të të rinjve kanë ngritur pranë Këshillit Bashkiak problematikat që lidhen me mjedisin. Me ta janë zhvilluar gjithashtu takime në kuadër të hartimit të Planit Social dhe Planit për Integrimin e Komunitetit Egjiptian. Nga ana tjetër janë hasur vështirësi për funksionimin e Këshillit Rinor të Bashkisë i cili është target për vitin 2020.<sup>26</sup>

Vetë të rinjtë mendojnë se zëri i të rinjve nuk dëgjohet mjaftueshëm:

*“Zëri i të rinjve dëgjohet në një masë jo shumë të gjerë në hartimin e programeve/ planeve/ aktiviteteve që lidhen me të rinjtë...”<sup>27</sup>*

<sup>23</sup>Burimi: Bashkia Përmet, Maj - Qershor 2020


<sup>24</sup>Burimi: Pyetësor me të rinjtë, Maj - Qershor 2020

<sup>25</sup>Burimi: Fokus grup me Këshillin Rinor, Maj - Qershor 2020

<sup>26</sup>Burimi: Bashkia Përmet, Maj - Qershor 2020

<sup>27</sup>Burimi: Fokus grup me Këshillin Rinor, Maj - Qershor 2020

**Grafiku 2: Përqindja e të rinjve që kanë marrë pjesë në takime që Bashkia ka zhvilluar me të rinjtë për përcaktimin e prioriteteve të zhvillimit të zonës<sup>28</sup>**



- Disa veprime janë ndërmarrë dhe në lidhje me **punësimin e të rinjve**, ku përfshihen: punësimi i të rinjve në bashki, bashkëpunimi me OJF dhe institucione që kanë si qëllim nxitjen e punësimit të të rinjve, si dhe angazhimi në projekte që synojnë punësimin:

**Business Club** ([http://www.bashkiapermet.gov.al/?page\\_id=4463](http://www.bashkiapermet.gov.al/?page_id=4463))

**STONE.ART** ([http://www.bashkiapermet.gov.al/?page\\_id=4474](http://www.bashkiapermet.gov.al/?page_id=4474))

Vetë të rinjtë identifikojnë nevojën e ndërmarrjes së më shumë nismave nga Bashkia për të nxitur punësimin e të rinjve.<sup>29</sup>

**30% e të rinjve konsiderojnë si prioritet nga Bashkia ofrimin e mundësive të punësimit dhe 23% e tyre ofrimin e trajnimeve/formimit profesional për të rinjtë.**

Progres i dukshëm gjatë periudhës 2019-2020 është vërejtur **në nxitjen e përfshirjes së të rejave/të rinjve në aktivitete mjedisore dhe turistike**. Vetë Bashkia i ka përfshirë të rinjtë në disa aktivitete mjedisore duke bashkëpunuar me shkollat. Gjithashtu, një ndër prioritetet e thirrjes RELOAD 2019 (zbatuar nga BE në bashkëpunim me Bashkinë) ka qënë edukimi mjedisor i të rinjve. Në kuadër të këtij projekti janë realizuar disa aktivitete si më poshtë:

- Eskursione dhe trajnime mbi mjedisin me të rinjtë;
- Plan për mjedisin e qëndrueshëm, ku ndër aktorët e përfshirë kanë qënë edhe të rinjtë;
- Krijimi i Këshillit Rinor Mjedisor;
- Mbledhje e diferencuar e mbetjeve në shkolla;
- Aksione pastrimi;
- Studim mbi perceptimin mjedisor të të rinjve;
- Ekspozitë riciklimi.<sup>30</sup>

<sup>28</sup>Burimi: Pyetësor me të rinjtë, Maj - Qershor 2020

<sup>29</sup>Burimi: Pyetësor me të rinjtë, Maj - Qershor 2020

<sup>30</sup>Burimi: Bashkia Përmet, Maj - Qershor 2020

Të rinjtë gjithashtu përmendin angazhimin në çështje që lidhen me mjedisin në bashkëpunim dhe me OJF-të që veprojnë në këtë fushë:

*“Kjo organizatë mbështet aktivizimin e të rinjve, si dhe në përfshirjen e të rinjve për të kontribuar në mbrojtjen e mjedisit dhe ruajtjes së biodiversitetit.”<sup>31</sup>*

- Progres është bërë gjithashtu ***në përfshirjen e të rejave/të rinjve në aktivitete artistike e kulturore***. Të rejtat/të rinjtë janë përfshirë në shumicën e aktiviteteve kulturore të realizuara të Bashkinë Përmet. Gjatë periudhës 2019-2020 janë ngritur Rrethet Kulturore pranë Qendrës Kulturore të Fëmijëve. Gjithashtu ka përfunduar ndërtimi i qendrës komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara, ku kati i parë përdoret për aktivitete kulturore. Në vazhdim të vitit 2020 parashikohet organizimi i më shumë aktiviteteve dhe në Njësitë Administrative.<sup>32</sup>

***25% e të rinjve përmendin aktivitete kulturore-artistike si aktivitete më interesante dhe të dobishme ku kanë marrë pjesë.***<sup>33</sup>

- Në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetit Publik dhe disa organizata janë zhvilluar disa ***aktivitete ndërgjegjësuese në fushën e edukatës shëndetësore.***<sup>34</sup>

Vetë të rinjtë gjithashtu konfirmojnë pjesëmarrjen në aktivitete që lidhen me edukatën shëndetësore, dhe pse njohin më shumë shkollën si aktorin kryesor të angazhuar në këtë drejtim:

*“Pushteti lokal është angazhuar në çështjet e shëndetit seksual, duke organizuar pyetësorë për të rinjtë dhe duke zhvilluar orë informimi në shkollat e qytetit, si dhe workshope të ndryshme të cilat kanë zgjatur rreth tre ditë.”<sup>35</sup>*

- Gjatë kësaj periudhe gjithashtu janë ndërmarrë aktivitete ***që nxitin përfshirjen e të rejave/të rinjve për arritjen e SDG-ve***. Projekti i RELOAD për vitin 2019 kishte, ndër të tjera, prioritet dhe përfshirjen e të rinjve në aktivitete social-kulturore të lidhura me SDG-të.<sup>36</sup>

#### 4. BUXHETI PËR RININË <sup>37</sup>

	Fusha	Buxheti i planifikuar (LEKË)	Buxheti i realizuar (LEKË)
Viti 2016	Arsimi i Mesëm	36,005,000	31,4668,349
	Kultura	7,650,000	6,242,244
	Sporti	4,000,000	3,731,606
	<b>TOTAL</b>	<b>47,655,000</b>	<b>41,642,199</b>

<sup>31</sup>Burimi: Fokus grup me Këshillin Rinor, Maj - Qershor 2020

<sup>32</sup>Burimi: Bashkia Përmet, Maj - Qershor 2020

<sup>33</sup>Burimi: Pyetësor me të rinjtë, Maj - Qershor 2020

<sup>34</sup>Burimi: Bashkia Përmet, Maj - Qershor 2020

<sup>35</sup>Burimi: Fokus grup me Këshillin Rinor, Maj - Qershor 2020

<sup>36</sup>Burimi: Bashkia Përmet, Maj - Qershor 2020

<sup>37</sup>Burimi: Bashkia Përmet, Maj - Qershor 2020

Viti 2017	Fusha	Buxheti i planifikuar (LEKË)	Buxheti i realizuar (LEKË)
	Arsimi i Mesëm	41,949,000	33,347,537
	Kultura	9,192,000	7,202,045
	Sporti	4,200,000	3,815,137
	<b>TOTAL</b>	<b>55,341,000</b>	<b>44,364,719</b>

Viti 2018	Fusha	Buxheti i planifikuar (LEKË)	Buxheti i realizuar (LEKË)	% ndaj totalit të buxhetit të Bashkisë (në Lekë)
	Arsimi i Mesëm	51,308,000	6,769,000	3%
	Kultura	10,337,000	7,994,000	3,4%
	Sporti	4,200,000	3,888,000	1,4%
	<b>TOTAL</b>	<b>65,845,000</b>	<b>18,651,000</b>	<b>7,8%</b>


Viti 2018	Fusha	Buxheti i planifikuar (LEKË)	Buxheti i realizuar (LEKË)	% ndaj totalit të buxhetit të Bashkisë (në Lekë)
	Arsimi i Mesëm	6,491,000	3,444,756	2%
	Kultura	10,587,000	8,897,864	4%
	Sporti	4,200,000	3,232,310	1%
	<b>TOTAL</b>	<b>21,278,000</b>	<b>15,574,930</b>	<b>7%</b>

Viti 2017	Fusha	Buxheti i planifikuar (LEKË)	% ndaj totalit të buxhetit të Bashkisë (në Lekë)
	Arsimi i Mesëm	8,247,000	3%
	Kultura	9,581,000	3%
	Sporti	5,815,000	2%
	<b>TOTAL</b>	<b>23,643,000</b>	<b>8%</b>


## 5. KOMUNIKIMI NË LIDHJE ME ÇËSHTJET E RINISË

- Për të bërë njoftime dhe komunikime të ndryshme, Bashkia Përmet ka një website zyrtar: [www.bashkiapermet.gov.al](http://www.bashkiapermet.gov.al). Përsa i përket çështjeve të rinisë, bashkia ka realizuar *3 seanca dëgjimore nga Këshilli Bashkiak* për problemet e rinisë, duke përfshirë çështjet:
  - Mbështetje për pjesëmarrje në konkurs;
  - Pjesëmarrja e të rinjve në mbledhje të Këshillit Bashkiak;
  - Prezantimi i studimit mbi perceptimin mjedisor të të rinjve.
  - Prezantimi i studimit mbi perceptimin mjedisor të të rinjve.

**Grafiku 3: Përqindja e të rinjve që listojnë kanalet e mëposhtme si burime informacioni<sup>39</sup>**



**Grafiku 4: Përqindja e të rinjve që deklarojnë se diskutojnë/ prezantojnë/ bëjnë me dije shqetësimet/ nevojat dhe kërkesat e tyre në burimet më poshtë<sup>40</sup>**



- Bashkia nuk mban të dhëna/informacione periodike për dhe mbi të rinjtë, si dhe nuk ka realizuar një anketim mbi nevojat apo prioritetet e tyre.<sup>41</sup>

Analiza e realizuar në bashkëpunim me Observatorin ka vlerësuar për Bashkinë si një dokument i rëndësishëm referimi për të identifikuar prioritetet për t'u adresuar nëpërmjet aktiviteteve si dhe për të aplikuar në projekte të ndryshme.<sup>42</sup>

<sup>38</sup>Burimi: Bashkia Përmet, Maj - Qershor 2020

<sup>39</sup>Burimi: Pyetësor me të rinjtë, Maj - Qershor 2020

<sup>40</sup>Burimi: Pyetësor me të rinjtë, Maj - Qershor 2020

Për të adresuar më mirë çështjet që lidhen me rininë, Bashkinë do ta ndihmonte:

- Një sektor i dedikuar për Rininë;
- Një Qendër Rinore;
- Mirëfunksionimi i Këshillit Rinor.<sup>43</sup>

Ndërkohë të rinjtë listojnë si shërbime që do të donin që Bashkia të ofronte:

***“Aktivitete kulturore; Përfshirja në mësimin e punëve artizanale; Punë vullnetare për të ndihmuar në pastrim mjedisi apo njerëzit në nevojë; Aktivitete dhe konkurse sportive; Aktivitete artistike; Punë sezonale duke përfshirë të rinjtë në periudhën e turizmit e duke i bërë pjesë e promovimit të aseteve që ka vendi ynë”<sup>44</sup>***

### **Hartëzimi i detyrimeve ligjore për NJQV dhe aktivitet e realizuara me fokus RININË, - Bashkia Përmet**

Ligji për vetë qeverisjen vendore - Kryesisht angazhime në parim	Nr	Përcaktimet ligjore për NJQV në lidhje me zhvillimin e politikave vendore rinore	Detyrimet / aktivitetet / tregues që rrjedhin për NJQV <sup>45</sup>	Angazhime të realizuara gjatë vitit 2018 – Bashkia Përmet <sup>46</sup>	Premtime në Plan buxhetin e Bashkisë viti 2019 – Bashkia Përmet <sup>47</sup>	Koment
	1	Realizimi i shërbimeve nga Qeverisja Vendore duhet të bëhet në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e antarëve të bashkësisë, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj apo akte të tjera normative, si dhe përmes nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore <sup>48</sup> .	- NJQV zhvillon një plan strategji zhvillim; <sup>49</sup> - Planeti e NJQV duhet të jenë në harmoni me ato kombëtare dhe rajonale. <sup>50</sup>			
	2	Funksionet e bashkisë në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike (kryesisht në mirëmbajtjen e institucioneve arsimore apo zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në fushën e shëndetësisë, etj) <sup>51</sup> .	- Realizimi i veprimtarive me dhe për rininë në fusha të ndryshme (shëndet, arsim, sociale, mjedis, etj). <sup>52</sup>		Nxitja e përfshirjes të të rinjve në aktivitete edukuese shëndetësore. <sup>53</sup>	
	3	Funksionet e bashkisë në fushën e shërbimeve sociale <sup>54</sup> .	- NJQV ndërmerr shërbime sociale targetuar Rininë; <sup>55</sup> .			
	4	Funksionet e bashkisë në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese. <sup>56</sup>	- NJQV bashkëorganizon me të rinjtë veprimtari në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese. <sup>57</sup>		Nxitja e përfshirjes të të rinjve në aktivitete kulturore. <sup>58</sup>	

<sup>43</sup>Këto detyrime/ aktivitete/ tregues janë gjenëruar bazuar në ligjet përkatëse ose janë evidentuar nga ekspertët e hartimit të këtij dokumenti;

<sup>46</sup>Të dhënat e prezantuara në këtë kolonë, janë bazuar në analizën “Të buxhetojmë për Rininë me Rininë, - Bashkia Përmet”; Burimi: <https://observator.org.al/wp-content/uploads/2018/12/Analiza-e-buxhetimit-per-rinine-ne-Bashkine-e-Permetit-Dhjetor-2018.pdf>

<sup>47</sup>Të dhënat e prezantuara në këtë kolonë, janë bazuar në analizën “Të buxhetojmë për Rininë me Rininë, - Bashkia Përmet”; Burimi: <https://observator.org.al/wp-content/uploads/2018/12/Analiza-e-buxhetimit-per-rinine-ne-Bashkine-e-Permetit-Dhjetor-2018.pdf>

<sup>48</sup>Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Nenin 3: pikat d), dh) dhe f).

<sup>49</sup>Diktuar nga ligji përkatës;

<sup>50</sup>Diktuar nga ligji përkatës;

<sup>51</sup>Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Nenin 23;

<sup>52</sup>Evidentuar nga ekspertët e hartimit të këtij dokumenti

<sup>53</sup>TË BUXHETOJMË PËR RININË ME RININË”; Bashkia e Përmetit, Q 5, V 5.1-V 5.2-V 5.3, fq 9;

Link: <https://observator.org.al/wp-content/uploads/2018/12/Analiza-e-buxhetimit-per-rinine-ne-Bashkine-e-Permetit-Dhjetor-2018.pdf>

<sup>54</sup>Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Nenin 24;

		sociale targetuar Rininë; <sup>55</sup>	
4	Funksionet e bashkisë në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese <sup>56</sup> .	- NJQV bashkëorganizon me të rinjtë veprimtari në në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese. <sup>57</sup>	Nxitja e përfshirjes të rinjve në aktivitete kulturore. <sup>58</sup>
5	Funksionet e bashkisë në fushën e mbrojtjes së mjedisit <sup>59</sup> .	- NJQV bashkëorganizon me të rinjtë veprimtari në në fushën embrojtjes së mjedisit, si: informim, ndërgjegjësim, edukim, apo qoftë dhe ngritjen e guidave dhe aktiviteteve publike, organizuar me të rinjte për promovimin e turizmit lokal, pastrimin mjedisi, etj. <sup>60</sup>	Nxitja e përfshirjes të rinjve në aktivitete mjedisore. <sup>61</sup>
6	Funksionet e bashkisë në fushën e zhvillimit ekonomik vendor <sup>62</sup> .	- NJQV ndërmerr nisma për fuqizimin ekonomik të të rinjëve, si: realizimi i kurseve te ndrsyhme të zhvillimit profesional, bashkëpunimi me donatorë apo Organizata, etj. <sup>63</sup>	
7	Funksionet e bashkisë në fushën e sigurisë publike <sup>64</sup> .	- NJQV ndërmerr nisma të gërshtuara dhe me institucionet e tjera lokale për	

<sup>55</sup>Evidentuar nga ekspertët e hartimit të këtij dokumenti

<sup>56</sup>Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Nenin 25;

<sup>57</sup>Evidentuar nga ekspertët e hartimit të këtij dokumenti;

<sup>58</sup>TË BUXHETOJMË PER RININË ME RININË; Bashkia e Përmetit, Q 4, V 4.1-V 4.2, fq 8; Link: <https://observator.org.al/wp-content/uploads/2018/12/Analiza-e-buxhetimit-per-rinine-ne-Bashkine-e-Permetit-Dhjetor-2018.pdf>

<sup>59</sup>Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Nenin 26;

<sup>60</sup>Evidentuar nga ekspertët e hartimit të këtij dokumenti;

<sup>61</sup>TË BUXHETOJMË PER RININË ME RININË; Bashkia e Përmetit, Q 3, V 3.1-V 3.2-V3.3, fq 8; Link: <https://observator.org.al/wp-content/uploads/2018/12/Analiza-e-buxhetimit-per-rinine-ne-Bashkine-e-Permetit-Dhjetor-2018.pdf>

<sup>62</sup>Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Nenin 28;

<sup>63</sup>Evidentuar nga ekspertët e hartimit të këtij dokumenti;

<sup>64</sup>Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Nenin 29;

Ligji për Financat e Vetëqeverisjes		çështje të sigurisë publike. <sup>63</sup>		
8	Detyrimi për konsultime publike nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJQV). <sup>66</sup>	NJQV organizon minimalisht 1 seancë konsultimi publik në (1) vit, me grupet e ndryshme të interesit që jetojnë në territorin e Bashkisë. <sup>67</sup>	Këshilli Bashkiak nuk ka zhvilluar seanca dëgjimore dedikuar çështjeve të rinisë.	
1	Kryetari i NJQV organizon seanca dëgjimore me komunitetin dhe grupet e interesit për projekt dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) të rishikuar <sup>68</sup> .	NJQV mund dhe duhet të mbështetini iniciativat të buxhetuara për rininë në linjë me nevojat e tyre. <sup>69</sup>	- Buxheti i Bashkisë dedikuar direkt ose indirekt rinisë është pjesë e programeve të Arsimit, Kulturës dhe Sportit.	
1	NJQV bashkëpunon me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) për politikat, projektet e programet në fushën e rinisë. <sup>70</sup>	NJQV harton plan strategjik për programe në fushën e rinisë. <sup>71</sup>	- Nuk 3një plan sektorial për Rininë. - Nuk 3një plan sektorial për kujdesin shëndetësor. - Nuk 3një plan sektorial për shërbimet sociale.	
2	NJQV kontribojnë në ofrimin e veprimtarive për të rinjtë në bashkëpunim me MASR, institucione dhe autoritete të tjera vendore, duke përcaktuar standardet në ofrimin e veprimtarive rinore dhe punës me rininë. <sup>72</sup>	NJQV harton standartet për ofrimin e veprimtarive rinore dhe punësimit të rinjve. <sup>73</sup>		
3	NJQV në përputhje me funksionet e tyre, hartojnë dhe zbatojnë politikat vendore në fushën e rinisë. <sup>74</sup>	Përcakton objektiva dhe prioritetet për të siguruar zbatimin e të drejtave të të rinjve. <sup>75</sup>		
3.1		KVR si organ këshillimor, funksionon pranë kryetarit të	- 3 Këshilli Rinor pranë Bashkisë	Përmirësimi i performancës së Këshillit Rinor, përmes shtimit të antarësisë dhe me përfaqësues nga grupe minoritare dhe të pafavorizuara, dhe nxitjes së pjesëmarrjes aktive të tij në proceset vendimmarrëse të Bashkisë. Hartimi i rregullores për funksionimin e KVR.

-KVR këshillon NJQV për drejtimin

<sup>66</sup>Evidentuar nga ekspertët e hartimit të këtij dokumenti;

<sup>67</sup>Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Nenin 16;

<sup>68</sup>Diktuar nga ligji përkatës;

<sup>69</sup>Ligji 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Nenin 38, pika 2;

<sup>70</sup>Diktuar nga ligji përkatës;

<sup>71</sup>Ligji 75/2019 "Për rininë", Neni 5;

<sup>72</sup>Diktuar nga ligji përkatës;

<sup>73</sup>Ligji 75/2019 "Për rininë", Neni 5;

<sup>74</sup>Diktuar nga ligji përkatës;

<sup>75</sup>Ligji 75/2019 "Për rininë", Neni 7;

<sup>76</sup>Diktuar nga ligji përkatës;



	<p>bashkisë. KVR kryesohet nga Kryetari dhe ka minimalisht 4-6 të rinj anëtarë. Kriteret, procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të KVR, si dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të tij miratohen me vendim të Këshillit Bashkiak.<sup>76</sup></p>	(Shtator 2017)		<p>e politikave dhe planeve vendore për rininë. - KVR vlerëson situatën dhe zbatimin e planeve dhe politikave rinore në nivel vendor. - KVR propozon përmirësime të politikave vendore, si dhe nismat për nevojat e të rinjve në territorin ku veprojnë. - KVR bashkëpunon dhe shkëmben informacion me Këshillin Kombëtar të Rinisë (KKR)</p>
3.2	<p>Organizimi dhe koordinimi i veprimtarive për fuqizimin dhe mbrojtjen e të rinjve.<sup>78</sup></p>	- NJQV nuk ka një specialist të dedikuar për rininë.		
3.3	<p>Organizimin dhe ofrimin e veprimtarive për të mbështetur mirëqenien dhe zhvillimin e të rinjve.<sup>79</sup></p>			
3.4	<p>Nxjtjen e vullnetarizmit të të rinjve dhe edukimin joformal të tyre.<sup>81</sup></p>	- Aktivitete ndërmjet shkollave.		
3.5	<p>Financimin e krijimit dhe të zhvillimit të infrastrukturës rinore dhe të hapësirave rinore të sigurta, - si Qendra rinore.<sup>82</sup></p>	- Nuk ka qendër rinore, por ka një qendër shumë-funkionale. - Mungojnë		

<sup>76</sup>Ligji 75/2019 "Për rininë", Neni 10;

<sup>77</sup>TË BUXHETOJMË PËR RININË ME RININË", Bashkia e Përmetit, Q 1, V 1.1, fq 7;

Link: <https://observator.org.al/wp-content/uploads/2018/12/Analiza-e-buxhetimit-per-rinine-ne-Bashkine-e-Permetit-Dhjetor-2018.pdf>

<sup>78</sup>Diktuar nga ligji përkatës;

<sup>79</sup>Diktuar nga ligji përkatës;

<sup>80</sup>TË BUXHETOJMË PËR RININË ME RININË", Bashkia e Përmetit, Q 2, V 2.1- V 2.2- V 2.3, fq 8;

Link: <https://observator.org.al/wp-content/uploads/2018/12/Analiza-e-buxhetimit-per-rinine-ne-Bashkine-e-Permetit-Dhjetor-2018.pdf>

<sup>81</sup>Diktuar nga ligji përkatës;

<sup>82</sup>Diktuar nga ligji përkatës;

3.6		Krijimin e strukturave administrative për çështjet e rinisë, si pjesë e NJQV. <sup>83</sup>	Organizata lokale për rininë - Ë punonjësi specialist i shëndetit, në Bashki.	
3.7		NJQV mbledh, analizon dhe raporton për situatën e të drejtave të të rinjve. <sup>84</sup>	- NJQV disponon të dhëna në lidhje me grupmoshën rimore 15-29 vjeç, banor të Bashkisë Përmet. - Nuk ka bërë ndonjë vlerësim për të identifikuar nevojat dhe prioritetet e të rinjve.	Vlerësimi i kërkesës së tregut të punës dhe traditës apo nevojave specifike të Përmetit në lidhje me kurset e formimit profesional që mund të ofrohen nga Agjencia e Formimit Profesional për të rejtat dhe të rinjtë. <sup>85</sup>
4	NJQV aplikon për t'u mbështetur nga programet kombëtare dhe ndërkombëtare për rininë, në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore në fuqi. <sup>86</sup>	Numri i aplikimeve të realizuara dhe të fituara nga NJQV me fokus ose përfshirë tematikën rimore. <sup>87</sup>		
5	NJQV bashkëpunon me institucione të tjera vendore nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve të përbashkëta, në përputhje me legjislacionin në fuqi për vetëqeverisjen vendore. <sup>88</sup>	- Numri i marrëveshjeve të realizuara me fokus ose përfshirë tematikën rimore. <sup>89</sup>  - Bashkëpunime të NJQV me institucione të tjera vendore. <sup>90</sup>	- Marrëveshje me Observatorin (2019-2021) - Programi "Këndi i BE-së" (2018)	
6	NJQV bashkëpunon me organizatat për të rinjtë e organizatat rimore shqiptare në diasporë, për të mbajtur komunikimin me	Numri i bashkëpunimeve apo aktiviteteve të tilla të		- Aktivitete sensibilizuese me qëllim

<sup>83</sup>Diktuar nga ligji përkatës;

<sup>84</sup>Diktuar nga ligji përkatës;

<sup>85</sup>TË BUXHETOJMË PËR RININË; Bashkia e Përmetit, Q 2, V 2.1, fq 8;

Link: <https://observator.org.al/wp-content/uploads/2018/12/Analiza-e-buxhetimit-per-rinine-ne-Bashkine-e-Permetit-Dhjetor-2018.pdf>

<sup>86</sup>Ligji 75/2019 "Për rininë", Neni 7;

<sup>87</sup>Diktuar nga ligji përkatës;

<sup>88</sup>Ligji 75/2019 "Për rininë", Neni 7;

<sup>89</sup>Diktuar nga ligji përkatës;

<sup>90</sup>Evidentuar nga ekspertët e hartimit të këtij dokumenti;

OZHQ/SDG	të rinjtë shqiptarë të Bashkisë, që janë larguar nga Bashkia apo vendi. <sup>91</sup>	realizuara. <sup>92</sup>		zvogëlimin e stereotipeve/diskriminimit gjinor dhe përfshirjen e të rejave dhe të rinjve në proceset vendimmarrëse dhe jetën publike. <sup>91</sup>
	1 OZHQ/SDG – Nxitja e përfshirjes së të rinjve në aktivitete për arritjen e OZHQ/SDG	- NJQV bashkërendon politikat dhe nismat me dhe për rininë në gërshetim me OZHQ/SDG. <sup>94</sup>	Marrëveshje me Observatorin (2019-2021)	- Aktivitete informuese mbi OZHQ/SDG <sup>95</sup> - Iniciativa "Rinia e Përmetit për OZHQ/SDG" <sup>96</sup> - Panairi i ideve "Dita botërore të aftësive të të rejave të rinjve" <sup>97</sup>

<sup>91</sup>Ligji 75/2019 "Për rininë", Neni 7;

<sup>92</sup>Diktuar nga ligji përkatës;

<sup>93</sup>TË BUXHETOJMË PËR RININË ME RININË", Bashkia e Përmetit, Q 1, V 1.1, fq 7; Link:

<https://observator.org.al/wp-content/uploads/2018/12/Analiza-e-buxhetimit-per-rinine-ne-Bashkine-e-Permetit-Dhjetor-2018.pdf>

<sup>94</sup>Evidentuar nga ekspertët e hartimit të këtij dokumenti;

<sup>95</sup>TË BUXHETOJMË PËR RININË ME RININË", Bashkia e Përmetit, Q 6, V 6.1-V 6.2-V6.3, fq 8;

Link: <https://observator.org.al/wp-content/uploads/2018/12/Analiza-e-buxhetimit-per-rinine-ne-Bashkine-e-Permetit-Dhjetor-2018.pdf>

<sup>96</sup>Ibid;

<sup>97</sup>Ibid.

## LISTA E SHKURTIMEVE

<b>E</b>	<b>Ekziston</b>
<b>AKZM</b>	<b>Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura</b>
<b>BE</b>	<b>Bashkimi Evropian</b>
<b>CIOFF</b>	<b>International Council of Organizations of Folklore Festivals and Folk Art</b>
<b>EU</b>	<b>European Union</b>
<b>KB</b>	<b>Këshilli Bashkiak</b>
<b>KKR</b>	<b>Këshillin Kombëtar të Rinisë</b>
<b>KVR</b>	<b>Këshilli Vendor i Rinisë</b>
<b>MASR</b>	<b>Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë</b>
<b>NJQV</b>	<b>Njësia e Qeverisjes Vendore</b>
<b>OZHQ/ SDG</b>	<b>Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm/ Sustainable Development Goals (Eng)</b>
<b>PBA</b>	<b>Programit Buxhetor Afatmesëm</b>
<b>PMB-OBS</b>	<b>Plani i Monitorimit të Buxhetit të vlerësuar nga Observatori</b>
<b>ReLOaD</b>	<b>Regional Local Democracy Programme</b>

